

VENDIM
Nr. 123, datë 1.12.2014

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT
PRODHUESË SHOQËRISË “FATLUM” SHPK PËR HEC “PERROLLAJ” SI BURIM I
RINOVUESHËM ENERGJIE

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “ll”; 9 dhe 39, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 3, pika 1, germa “f”; të ligjit nr. 138/2013, “Për burimet e energjive të rinovueshme”, të ndryshuar, nenit 9, pika 1, dhe 2, germa “a” të Rregullave dhe Procedurave të Certifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 1.12.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Fatlum” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për kualifikimin e impianteve prodhues të shoqërisë “Fatlum” sh.p.k., për HEC-in “Perrollaj” me fuqi të instaluar totale 0,5 MW, si burim i rinovueshem energjie.

konstatoi se:

- Aplikimi i shoqërisë “Fatlum” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”

Përshkrimi i përgjithshëm i centralit.

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

- Neni 7, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”

Dokumentacioni vijues grafik, koreografia, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.

Ky dokumentacion është paraqitur në mënyrë korrekte.

- Neni 7 pika 3, gjerat “a”, “b”, “c”

Përshkrimi i centralit.

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Fatlum” sh.p.k., për kualifikim impianti prodhues për HEC “Perrollaj”, si burim i rinovueshem energjie me fuqi të instaluar 05 MW.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti